

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, – kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Hashim Çollaku kryetar i kolegjit, Ferit Osmani dhe Shqipe Qerimi anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Hysni Ismaili, në çështjen penale kundër të akuzuarve N.V., V.V. dhe I.V., që të gjithë nga fshati ..., Komuna e Suharekës, për shkak të veprës penale në bashkëkryerje Pengim i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare, nga neni 409 par. 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, duke vendosur përkitazi me ankesën e Prokurorit të Prokurorisë Themelore në Prizren, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren – Dega Suharekë, P.nr.225/2015, datë 10.03.2017, në seancën e kolegjit të mbajtur më 08.06.2017, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Prokurorit të Prokurorisë Themelore në Prizren, kurse aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren – Dega Suharekë, P.nr.225/2015, datë 10.03.2017, **vërtetohet**.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Prizren – Dega Suharekë, me aktgjykimin P.nr.225/2015, datë 10.03.2017, të akuzuarin N.V. ka shpall fajtor për shkak të veprës penale në bashkëkryerje Pengim i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare, nga neni 409 par. 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, dhe i shqiptoj dënim me burgim në kohëzgjatje prej 5 (pesë) muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet në afatin e verifikimit prej 2 (dy) viteve, nëse i akuzuari nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale, të akuzuarin V.V., e ka shpall fajtor për shkak të veprës penale në bashkëkryerje Pengim i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare nga neni 409 par. 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, dhe i shqiptoj dënim me burgim në kohëzgjatje prej 5 (pesë) muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet në afatin e verifikimit prej 2 (dy) viteve, nëse i akuzuari nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale, të akuzuarin I.V., e ka shpall fajtor për shkak të veprës penale në bashkëkryerje Pengim i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare nga neni 409 par. 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, dhe i shqiptoj dënim me burgim në kohëzgjatje prej 4 (katër) muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet në afatin e verifikimit prej 2 (dy) viteve, nëse të akuzuarit nuk kryejn ndonjë vepër tjetër penale. Janë obliguar të akuzuarit që në emër të

shpenzimeve për ekspertizën mjeko – ligjore secili veç e veç ta paguajn shumën prej 7 €, si dhe paushallit gjyqësor secili veç e veç të paguaj shumën prej 20 €, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit. Janë udhëzuar palët e dëmtuara A.K., H.K., G.K. dhe P.M. që kërkesën pasurore juridike ta realizojnë në kontest të rregull civil.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor ankesë ka paraqitur Prokurori i Prokurorisë Themelore në Prizren, dhe atë vetëm për shkak të vendimit mbi dënimin, me propozim që Gjykata e Apelit në Prishtinë, aktgjykimin e ankimuar ta ndryshojë dhe të akuzuarve t'iu shqiptoj dënim me të rëndë.

Prokurori i Apelit, me parashtresën me shkrim PPA/II.nr.547/2017, datë 12.05.2017, ka propozuar që të aprovohet si e bazuar ankesa e Prokurori i Prokurorisë Themelore në Prizren, ndaj të akuzuarve të shqiptohet dënim me i ashpër.

Gjykata e Apelit, pasi shqyrtoj të gjitha shkresat e kësaj çështje juridiko-penale, studioj aktgjykimin e ankimuar në kuptim të nenit 394 të KPPK-së, dhe pas vlerësimeve të pretendimeve në ankesë, gjeti se:

Ankesa nuk është e bazuar.

Edhe pse aktgjykimi i shkallës së parë nuk ankimohet për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, megjithatë Gjykata e Apelit të njëjtin sipas detyrës zyrtare e shqyrtoj edhe në këtë aspekt, konform dispozitës se nenit 394 të KPPK-së dhe konstatoj se ai nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, e të cilat kishin me kushtëzuar anulimin e tij, si dhe as shkelje të Ligjit Penal në dëm të të akuzuarve.

Po ashtu as gjendja faktike nuk ka qenë objekt vlerësimi e kësaj gjykate, ngase në ankesë nuk ka mundur të kontestohet, sepse i akuzuari në shqyrtimin gjyqësor të akuzuarit e kan pranuar fajësinë për të gjitha pikat e akuzës, edhe gjykata është pajtuar me një pohim të tillë, prandaj sipas nenit 383 par. 2 të KPPK-së, ndaj aktgjykimit që është marrë në bazë të pranimit të fajësisë ose marrëveshjes për pranimin e fajësisë nuk lejohet ankesa për gjendjen e fakteve, aktgjykimi i ankimuar u vlerësua vetëm në frymën e pretendimeve ankimore sa i përket vendimit për dënim.

Sa i përket vendimit për dënim, Prokurori në ankesë pretendon se gjykata e shkallës së parë në rastin e shqiptimit të dënimit për të akuzuarit ka bërë shkelje të ligjit penal konkretisht nenit 74 dhe 75 të KPRK-së, pasi që edhe për kundër faktit se kishte shumë rrethana rënduese në këtë rast e sidomos faktit se të njëjtit janë të përfshirë edhe në një numër të rasteve të hapur ndaj tyre për vepra penale të ngjashme dhe të natyrës tjetër, e sidomos N.V. dhe I.V., ditën kritike të akuzuarit kishin penguar personat zyrtar A.K., H.K., G.K. dhe P.M. të cilët kishin shkuar për të intervenuar në rast për shkak të dyshimit që kishte të shtëna me armë në restorantin “Nn” ku ishin duke pirë aty të akuzuarit në fjalë dhe të njëjtit me arrogancë nuk i janë bindur urdhrave të

zyrtarëve policorë dhe të njëjtit i kanë kanosur dhe fyer me fjalë më të rënda ofenduese duke marrë parasysh vendin në të cilin është kryer vepra penale, kohën, rrethanat, e bënë të njëjtën vepër si të rrezikshme duke pasur parasysh faktin se aty është dyshuar për gjuajtje me armë zjarri dhe po ashtu ka pasur një numër të madh të mysafirëve, vërtetohet se të njëjtit kanë një numër të madh të rasteve të hapura ndaj tyre, e sidomos të akuzuarit I.V. dhe N.V.. Mbi bazën e mësipërme, gjykata të akuzuarve ju ka shqiptuar dënime të butë, duke pasur parasysh rrethanat e kryerjes së veprës penale, dashjes së kryesve, minimumin dhe maksimumin për këtë vepër, gjykata ka shkuar në minimum të dënimit dhe atë të kushtëzuar, përkundër faktit se nuk kishte asnjë rrethanë lehtësuese në këtë rast, që do të ndikonte që gjykata të jep një dënim më të butë, gjykata është dashur të jep një dënim më të ashpër në mënyrë që këtë dënim të reflektoj përveç të akuzuarve, edhe të tjerëve në preventivë, gjykata me rastin e marrjes së vendimit ndaj të akuzuarve të lartcekur është dashur të ketë për bazë natyrën e kësaj vepre penale, pengimi i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, pretendimet e më sipërme ankimore të Prokurorit për ndryshimin e aktgjykimit të ankimuar në atë mënyrë që të akuzuarve t'iu shqiptohen dënime më të ashpëra, nuk janë të bazuara. Gjykata e shkallës së parë konform dispozitës së nenit 73 dhe 74 të KPRK-së, i ka vlerësuar rrethanat lehtësuese dhe rënduese që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, me ç' rast për të akuzuarit si rrethanë lehtësuese mori për bazë se të akuzuarit kanë pasur qëndrim korrekt ndaj gjykatës, si rrethanë rënduese mori për bazë sjelljen e mëparshme të kryesve, ashtu që të akuzuarit gjinden në evidencë gjyqësore edhe si kryes të veprave tjera penale kurse rrethana posaçërisht rënduese nuk gjeti. Një vlerësim të këtillë të rrethanave relevante për matjen e dënimit si të drejtë dhe të ligjshëm e pranon edhe kjo gjykatë dhe vlerëson se dënimi i shqiptuar të akuzuarit nga ana e gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe në pajtim me dispozitat ligjore. Rrethanat e pretenduara rënduese në ankesën e Prokurorit, sipas vlerësimit të kësaj gjykate nuk janë të asaj rëndësie që të ndikonin në shqiptimin e një dënimi tjetër nga ai të cilin e ka shqiptuar gjykata e shkallës së parë, pastaj nuk mundë të merren si rrethana rënduese fakti se ndaj tyre zhvillohet procedurë për vepra tjera penale pa aktgjykim të formës së prerë, e duke marrë për bazë mënyrën dhe rrethanat në të cilat është kryer vepra penale, si dhe rrethanat tjera të konstatuara nga gjykata e shkallës së parë, e me qenë se në ankesë nuk çeket ndonjë rrethanë e re rënduese, e cila kishte me pas ndikim në shqiptimin e një dënimi më të ashpër, kjo gjykatë vlerëson se dënimi i shqiptuar t[akuzuarve si në dispozitivin e aktgjykimit të ankimuar është në harmoni me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarve si ekzekutor dhe me intensitetin e rrezikimit apo të dëmtimit të vlerës së mbrojtur, e posaçërisht duhet të jetë në funksion të preventives gjenerale dhe individuale, forcimit të moralit të shoqërisë si dhe përgjegjësisë dhe disiplinës së qytetarëve dhe se me dënimin e shqiptuar kryerësi do të parandalohet nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, do të bëhet rehabilitimi i tij dhe do të ndikoj në përmbajtjen e personave tjerë nga kryerja e veprës penale, kjo gjykatë konsideron se me dënimin e shqiptuar të akuzuarit nga gjykata e shkallës së parë do të arrihet edhe qëllimi i ndëshkimit i paraparë me dispozitat e neni 41 të KPRK-së.

Nga sa u tha më lartë, e në bazë të nenit 401 të KPPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS

PA1.nr.526/17, datë 08.06.2017

Bashkëpunëtori profesional
Hysni Ismaili

Kryetari i kolegjit
Hashim Çollaku

Anëtarët e kolegjit:

Ferit Osmani
Shqipe Qerimi